



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/02-0076842/21 dt. 19.12.2025
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe nenin 13 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Rregulloren Nr. 01/ 2023 për Mënyrën e Mbajtjes së Evidencës dhe Raportimit për Zbatim të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M

(Për emërimin e Zyrtar/es Përgjegjëse për Qasje në Dokumente Publike)

1. **Emërohet** znj. Sofije Rushiti, Zyrtare Përgjegjëse për Qasje në Dokumente Publike për Komunën e Mitrovicës Jugore.
2. Zyrtar-ja e emëruar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi është e obliguar që të trajtojë të gjitha kërkesat e parashtruara për Qasje në Dokumente Publike në Komunë, konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, dhe të njëjtat t'i procedojë për Vendimmarrje tek Kryetari i Komunës.
3. Për kërkesat e pranuar dhe të trajtuara e njëjta obligohet që ti raportoj Kryetarit të Komunës dhe Agjencisë për Informim dhe Privatësi në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Në rast të mungesës së Zyrtares të Emëruar për Qasje në Dokumente Zyrtare, kompetente për trajtimin e kërkesave është Zyra për Informim.
5. Mandati i Zyrtares së emëruar është 1 (një) vjeçar me mundësi vazhdimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Shtojcë:

1x1 E-mail i z. Shkelzen Haliti, Kabineti i Kryetarit i datës 19.12.2025.

Ti dorëzohet:

1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 znj. Sofije Rushiti
1x1 Arkivit